



SEVENTH ENVIRONMENTAL AND SOCIAL BULLETIN
BULETINI I SHTATË MJEDISOR DHE SOCIAL



Tirana International Airport
Nënë Tereza

Table of contents

Tabela e përmbajtjes

Message from the CEO
Mesazhi nga CEO

3

Integrated Management System
Sistemi i Integruar i Menaxhimit

4

Health and Safety
Shëndeti dhe Siguria

18

Customers and Social Aspects
Klientët dhe Aspekte Sociale

22

Social activities and airport main events
Aktivitetet sociale dhe ngjarjet kryesore

28

Facts and Figures
Fakte dhe Shifra

30



Rolf Castro-Vasquez
CEO

Dear Passenger,

We are very pleased this year to have once again demonstrated our commitment to the environment. In doing so we have raised awareness of the concept of quality of life among our passengers, community, partners and young people encouraging them with the sense of responsibility towards environmentally friendly living, and sustainable use of resources.

Tirana International Airport (TIA) has established a new policy on energy, and this is not about always costs reduction. It is a way to bring people together and raise awareness about improving energy efficiency, energy saving and carbon reduction, based upon corporate responsibility and client satisfaction.

TIA has defined an Airport carbon footprint and has become carbon accredited at the Mapping level. This achievement is testimony to TIA's commitment to addressing the impact of aviation on climate change, reduction of greenhouse gas emissions and energy saving.

The Seventh Environmental and Social Bulletin continues to focus on the Company's energy management, which is key towards sustainable development. TIA has clear objectives and has undertaken real projects in infrastructure improvements for the optimisation of the use of energy.

Of course, this is a continuing process and common efforts with all the parties involved.

Together we can improve our lives,

Rolf Castro-Vasquez.

I dashur Pasagjer,

Jemi të kënaqur që sërish këtë vit treguam zotimin tonë ndaj mjedisit. Besojmë se kemi rritur ndërgjegjësimin për konceptin e një jete cilësore tek pasagjerët, komuniteti, partnerët, dhe gjenerata e re, duke nxitur sensin e përgjegjshmërisë ndaj një mjedisi jetësor më miqësor, dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve.

Tirana International Airport (TIA) ka vendosur një politikë të re mbi energjinë dhe nuk bëhet fjalë gjithmonë për reduktimin e kostove. Bëhet fjalë për mënyrën që njerëzit të mblidhen së bashku dhe të ndërgjegjësohen mbi përmirësimin e rrugëve për efektshmërinë e energjisë, për ta kursyer atë dhe për të reduktuar karbonin, bazuar në përgjegjësinë e kompanisë dhe kënaqësinë e klientit.

TIA ka përcaktuar gjurmët e karbonit dhe është akredituar në nivelin e parë përsa i përket sasisë së emetimit të tij. Kjo arritje është një dëshmi e angazhimit të TIA-s për të adresuar sfidat e ndryshimeve klimatike, duke vlerësuar dhe zvogëluar emetimet e gazit dhe për të arritur kursimin e energjisë.

Buletini i Shtatë Mjedisor dhe Social vazhdon të përqendrohet në menaxhimin e energjisë, që është çelësi drejt të një zhvillimi të qëndrueshëm. TIA ka objektiva të qarta dhe ka ndërmarrë projekte konkrete në përmirësimin e infrastrukturës për optimizimin e përdorimit të energjisë.

Sigurisht, ky është një proces i vazhdueshëm dhe i përpjekjeve të përbashkëta, ku të gjitha palët janë të përfshira.

Së bashku mund t'i përmirësojmë jetët tona,

Rolf Castro-Vasquez

Integrated Management System

Sistemi i Integruar
i Menaxhimit



Throughout 2012, Tirana International Airport (TIA) demonstrated its commitment to comply with the applicable legislation and standards and to continuously improve performance on environmental, health and safety standards, aiming an sustainable development of the Airport.

In May 2012, TIA established a new policy on Energy consisting of energy saving and reduction of carbon emissions. It also set up programmes on energy management, reduction of CO₂ emissions, sustainable use of resources, and made the requisite investments.

To face these new challenges an Energy Management System was set up orientated towards ISO 50001. In this regard the Environmental and Quality Management System has been upgraded into an Integrated Management System (IMS), in compliance with ISO standards 9001, 14001, and 50001, that aims at integrating environmental protection and quality management with energy efficiency. A consistent, systematic and integrated approach is considered very important for the Airport as there many stakeholders involved in its operations.

Legal Compliance

Tirana International Airport performs its activities in accordance with all applicable legislation, requirements and standards and in compliance with environmental, health and safety permits.

Gjatë gjithë vitit 2012, Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës (TIA) ka treguar angazhimin e tij për t'iu përmbajtur kuadrit ligjor të zbatueshëm dhe standardeve në fuqi, për të përmirësuar më tej performancën në lidhje me standardet e mjedisit shëndetit dhe sigurisë, duke synuar në këtë mënyrë zhvillimin e qëndrueshëm të aeroportit.

Në majin e vitit 2012, Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës ka zhvilluar një politikë të re mbi energjinë të bazuar në kursimin e energjisë dhe pakësimin e nivelit të emetimit të dioksidit të karbonit në mjedis. TIA ka hartuar gjithashtu programe për menaxhimin e energjisë, reduktimin e nivelit të emetimit të dioksidit të karbonit në atmosferë, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve si dhe ka kryer investimet e nevojshme.

Për t'u përballur me këto sfida është ngritur një sistem menaxhimi i energjisë i orientuar në përputhje me standardet ISO 50001. Në këtë kuader sistemi i menaxhimit të mjedisit dhe cilësisë është zhvilluar më tej në një sistem të integruar menaxhimi në përputhje me standardet ISO 9001,14001 dhe 50001. Ky sistem i integruar menaxhimi synon të ndërthurë mbrojtjen mjedisore dhe menaxhimin e cilësisë me efikasitetin e energjisë. Nisur nga fakti se shumë grupe interesi janë të përfshira në operimin aeroportual, një qasje konsekuente, sistematike dhe e integruar, konsiderohet si shumë e rëndësishme për aeroportin.

Përputhshmëria Ligjore

Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me të gjithë kuadrin ligjor të zbatueshëm si dhe kërkesat dhe standardet që janë në përputhje me lejet mjedisore, të shëndetit dhe sigurisë.

ENVIRONMENTAL MONITORING AND MANAGEMENT


TIA's environmental management programme, based on the environmental objectives and targets set up by TIA in the Environmental, Health & Safety and Social Action Plan (EHSAP), addresses all identified Airport activities with potential impact on the environment.

Monitoring of all necessary environmental parameters is carried out periodically in compliance with environmental, health and safety permits, standards and legislation in force. Sampling and analysis are carried in cooperation with licensed experts and accredited laboratories.

In the framework of the monitoring programme, preventative and mitigation measures are recommended by TIA in order to reduce as much as possible adverse impacts on the environment.

The environmental aspects monitored by TIA include, among others, air quality, water quality, waste water, noise, waste.


PM_{10} (particulate matter < 10 μm) Units, $\mu m/m^3$
 PM_{10} (grimcat e pluhurit< 10 μm) Njësi, $\mu m/m^3$



*s/w –summer/winter

*s/w - verë/dimër

CO (carbon monoxide) Units, mg/m³
 CO (monoksid karboni) Njësi, mg/m³



AIR QUALITY MONITORING

TIA measured and monitored the concentration of the pollutants in the atmosphere that can directly impact public health and the natural environment. Emission sources located at the Airport are dominated by aircraft, ground support equipment, vehicles, emergency generators, fuel storage and handling. The monitoring of air quality is carried out in conformity with the legislation in force, TIA procedures and other regulations to check compliance with Albanian and EU standards.

TIA carried out monitoring of the air quality parameters PM_{10} (particulate matter < 10 μm), CO (carbon monoxide), SO_2 (sulphur dioxide), NO_2 (nitrogen dioxide) and O_3 (ozone) during both peak and non-peak seasons.



MENAXHIMI DHE MONITORIMI MJEDISIT


Bazuar në synimet dhe objektivat mjedisore të parashikuar në Planin e Veprimit për Mjedisin Shëndetin, Sigurinë dhe atij Social, programi i menaxhimit mjedisor të Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës merr në konsideratë të gjitha aktivitetet e identifikuara me ndikim të mundshëm në mjedis.

Monitorimi i të gjithë parametrevë të nevojshëm mjedisore kryhet në mënyrë periodike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, standardet dhe lejet për mjedisin, shëndetin dhe sigurinë. Marrja e mostrave dhe analizimi i tyre kryhet në bashkëpunim me ekspertë të licensuar dhe laboratorë të akredituar.


Në kuadër të këtij programi monitorimi, TIA ka ndërmarrë masa parandaluese dhe lehtësuese me qëllim minimizimin me sa është e mundur të efekteve negative në mjedis.

Aspektet mjedisore të monitoruara nga TIA përfshijnë, mes të tjerash, cilësinë e ajrit, cilësinë e ujit, ujrat e ndotura, nivelet e zhurmave në mjedis dhe mbetjet.


SO₂ (sulphur dioxide) Units, µm/m³
SO₂ (dioksid sulfuri) Njësi, µm/m³



NO₂ (nitrogen dioxide) Units, µm/m³
NO₂ (dioksid azoti) Njësi, µm/m³



O₃ (ozone) Units, µm/m³
O₃ (ozon) Njësi, µm/m³



*s/w –summer/winter

*s/w - verë/dimër

MONITORIMI I CILËSISË SË AJRIT

TIA ka matur dhe monitoruar përqëndrimin e ndotësve në atmosferë, të cilët mund të kenë ndikim të drejtëpërdrejtë mbi mjedisin natyror dhe shëndetin publik. Burimet e shkarkimeve në ajër të pranishme në Aeroport dominohen nga avionët, mjetet për shërbimet e transportit në tokë, gjeneratorët e emergjencës, trajtimi dhe magazinimi i karburantit. Monitorimi i cilësisë së ajrit kryhet në përputhje me legjisllacionin në fuqi, procedurat e TIA-s si dhe rregulloret e tjera me qëllim për të kontrolluar përputhshmërinë me standardet shqiptare dhe atyre të Bashkimit Evropian.

TIA ka kryer monitorimin e parametrevë të cilësisë së ajrit duke përfshirë PM₁₀ (grimcat e pluhurit <10 µm), monoksid karboni (CO), dioksid sulfuri (SO₂), dioksid azoti (NO₂) dhe ozon (O₃) gjatë periudhave të pikut dhe atyre jo të pikut.

Pajisjet e monitorimit janë instaluar në vendodhje të paracaktuara nga TIA për të mbledhur dhe analizuar të dhënat mbi përqëndrimin e ndotësve atmosferikë si më poshtë:

- Cilësia e ajrit në zonën ajrore, pozicioni 1 (ajri në ambjentet e jashtme)
- Terminali i pasagjerëve, pozicioni 2 (ajri në ambjentet e brendshme)
- Vendparkimi i mjeteve, pozicioni 3 (ajri në ambjentet e jashtme)

Të gjitha pajisjet dhe metodologjitë e monitorimit janë në përputhje me standardet përkatëse të saktësisë, kalibrimit, verifikimeve dhe raportimit.

Rezultatet e përftuara nga monitorimi janë nën limitet e pranueshme të Shqipërisë të parashikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave VKM Nr. 803, datë 4 dhjetor 2003 “Për normat e cilësisë së ajrit”, dhe kufinjët e lejuar të Bashkimit Evropian, të paraqitura në grafikun si më poshtë (“s” summer/verë dhe “w” winter/dimër).

Monitoring equipment is installed at predefined locations to collect and analyse atmosphere pollutants, as follows:

- Airside area, Position No. 1 (outdoor air)
- Passenger terminal, Position No. 2 (indoor air)
- Vehicle parking, Position No. 3 (outdoor).

All monitoring equipment and methodologies are in compliance with relevant standards for accuracy, calibration, verification and reporting.

The results obtained fall below the country's upper limits, given in the Decision of the Council of Ministers (DCM) No. 803 dated 04.12.2003, "On the norms of air quality" and EU allowable limits, as shown in the graphs below:

WATER MANAGEMENT

Water management programmes are implemented by TIA to ensure good water quality and encourage continuous reduction in water consumption, achieve savings in water pumping and treatment costs, and improve the sewage sludge disposal process.

The system of oil separators is cleaned and properly maintained, while usage of pesticides is controlled.

TIA has contracted a licensed company for the transportation and final disposal of sludge generated after waste water treatment.

The purpose of TIA's water monitoring programme is to assess the quality of potable water, surface water, groundwater and treated waste water.

Potable Water Monitoring

Drinking water samples are taken periodically in compliance with TIA's procedure on Water Quality Monitoring. The samples are collected and analysed by the laboratory of the Directory of Public Health and State Sanitary Inspectorate. The analyses report shows that drinking water microbiological and chemical parameters are continuously in compliance with health and safety standards.

Waste Water Monitoring

Periodically, TIA monitors the main parameters of treated waste water before discharge into Terkuza River. Monitoring of TIA's waste water is conducted based on DCM No. 177, dated 31.03.2005, on "Permitted norms for liquid discharges and criteria for environmental zoning of rivers or sea waters".

According to the environmental permit for the construction and operation of the Waste Water Treatment Plant issued by the Ministry of Environment, the parameters for analysis include BOD5 (Biological Chemical Demand), COD (Chemical Oxygen Demand), and suspended solids. The reports provided by the accredited laboratory show that the values of these parameters fall below the limits set by the respective decision, and are fully compliant with both Albanian and EU standards.





MENAXHIMI I UJRAVE

Programet e menaxhimit të ujrave zbatohen nga Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës (TIA) për të siguruar një cilësi të mirë të ujit dhe për të nxitur zvogëlimin e vazhdueshëm të konsumit të ujit, për të siguruar kursime në stacionin e pompimit të ujit si dhe në kostot e trajtimit të ujit si edhe për përmirësuar procesin e shkarkimit të llumrave.

Sistemi i veçuesve të vajit për ujrën sipërfaqësor pastrohet dhe mirëmbahet, ndërsa përdorimi i pesticideve mbahet nën kontroll.

TIA ka kontraktuar një kompani të licensuar për transportin dhe depozitimin përfundimtar të llumit që gjenerohet në fund të procesit trajtimit të ujrave të ndotur.

Qëllimi i programit të monitorimit të ujrave është që të vlerësojë cilësinë e ujit të pijshëm, ujrave sipërfaqësore, nëntokësore dhe trajtimin e ujrave të ndotur.

Monitorimi i Ujrave të Pijshëm

Mostrat e ujit të pijshëm merren periodikisht në përputhje me procedurat e TIA-s për monitorimin e cilësisë së ujit. Mostrat grumbullohen dhe analizohen nga laboratorit i Drejtorisë së Shëndetit Publik dhe Inspektoriatit Sanitar Shtetëror. Rezultatet e analizave dëshmojnë që parametrat mikrobiologjikë dhe kimikë të ujit të pijshëm janë në vazhdimësi në përputhje me standardet e shëndetit dhe të sigurisë.

Monitorimi i Ujrave të Ndotura

TIA monitoron në mënyrë të vazhdueshme parametrat kryesorë të ujrave të ndotur përpara se ato të derdhen në lumin Tërkuzë. Monitorimi i ujrave të ndotur të TIA-s kryhet bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 177 dt. 31.03.2005, "Mbi normat e lejuara për shkarkimet e lëngshme dhe kriteret për ndarjen zonale mjedisore të lumenjve dhe deteve".

Sipas lejes mjedisore për ndërtimin dhe funksionimin e impiantit për përpunimin e ujrave të ndotura, lëshuar nga Ministria e Mjedisit, parametrat e analizës përfshijnë kërkesën biokimike për oksigjen, kërkesën kimike për oksigjen dhe lëndët pezull. Raportet e siguruar nga laboratorit i akredituar dëshmojnë se vlerat e këtyre parametrave janë nën limitin e përcaktuar nga vendimi i mësipërm i Këshillit të Ministrave dhe janë në përputhje të plotë si me standardet shqiptare ashtu edhe me ato Bashkimit Evropian.

MONITORIMI I ZHURMAVE

Nivelet e zhurmave monitorohen në mënyrë të vazhdueshme në zonën e aeroportit dhe pranë tij, në përputhje me procedurat e TIA-s, udhëzimet e Organizatës Botërore të Shëndetit (WHO) dhe kuadrin ligjor të Bashkimit Evropian.

Në vitin 2012, TIA nisi monitorimin në mënyrë të vazhdueshme të nivelit të zhurmës përmes një sistemi të ri të monitorimit të zhurmave, i përbërë nga dy instrumente monitorimi statikë model CR 243/4 të vendosur në dy skajet e pistës së aeroportit. Këto dy instrumente lidhen me anë të një modemi me një kompjuter qendror në të cilin të dhënat rregjistrohen duke përdorur një program kompjuterik i dedikuar për matjen e nivelit të zhurmave. Programi gjeneron raporte periodike dhe raporte për situata të veçanta, raporte kalibrimi dhe të dhëna të tjera mbi nivelet e zhurmave. Eventet e avionëve identifikohen me anë të një paraqitje grafike të matjeve të vazhdueshme dhe të parametrave të identifikimit të zhurmave nga avionët.

NOISE MONITORING

Permanent noise monitoring is carried out to estimate noise levels at the Airport and in its vicinity in compliance with TIA's procedures, WHO guidelines and Albanian and EU legal requirements.

In 2012, TIA started to monitor noise levels as part of a new permanent noise monitoring system, which is composed of two stationary monitoring instruments model—CR: 243/4—located at the two ends the runway. These two instruments are connected via modem to a central computer, where data are recorded using a noise hub software. The software generates regular reports, reports for specific events, calibration records and other noise data. Aircraft noise events are identified with the help of a graphical display of constant measurements and aircraft noise identification parameters.

Noise monitoring data consist of 24 hour measurements conducted during daytime 07.00–19.00 hrs, evening 19.00–23.00 hrs, night-time 23.00–07.00 hrs.

The table below provides a summary of the noise measurements taken during 2012 for the two fixed noise-monitoring instruments located at the northern and southern ends of the runway.

Equivalent sound level and Maximum noise level

Location	Time	Equivalent sound level Laeq (dBA)	Maximum noise level Lamax (dBA)
NORTH Position 1/1	Day	58.6	93.3
	Evening	53.1	87.0
	Night	46.3	86.3
SOUTH Position 1/2	Day	62.5	91.3
	Evening	51.4	87.3
	Night	44.6	84.5

During the period 1–2 June 2012, TIA undertook noise measurements inside Qereka School. Noise levels during daytime were 50 dB(A) while the average value for the area was calculated as 49 dB (A), as monitored during the days and nights.

All noise monitoring results obtained were found to fall within the limits defined in Guideline No. 8, dated 27.11.2007, "On noise limits in specific environments", which is based on World Health Organization (WHO) standards.





Monitorimi konsiston në matje 24-orëshe të zhurmave të kryera në intervalet kohore gjatë ditës 07.00–19.00, gjatë orëve të mbrëmjes 19.00–23.00 dhe të natës 23.00–07.00.

Tabela më poshtë paraqet një përmbledhje të matjeve të kryera gjatë 2012 nga dy instrumentet statikë të matjes së niveleve të zhurmave të vendosura në skajin verior dhe jugor të pistës.

Niveli mesatar dhe niveli maksimal i zhurmave

Vendndodhja	Intervali Kohor	Niveli mesatar i zhurmave Laeq (dBA)	Niveli maksimal i zhurmave Lamax (dBA)
Pozicioni verior 1/1	Ditë	58.6	93.3
	Mbrëmje	53.1	87.0
	Natë	46.3	86.3
Pozicioni jugor 1/2	Ditë	62.5	91.3
	Mbrëmje	51.4	87.3
	Natë	44.6	84.5

Gjatë periudhës 1-2 qershor 2012, TIA ndërmori matje të zhurmave brenda shkollës së Qerekës. Nivelet mesatare të zhurmave gjatë ditës ishin 50 db(A) ndërkohë që vlera mesatare e përlogaritur për zonën ishte 49 db(A) bazuar kjo në monitorimet gjatë ditës dhe gjatë natës.

Të gjitha rezultatet e përfuara nga monitorimi i nivelit të zhurmave përkonin me kufinj të parametrave të përcaktuar në Udhëzimin Nr. 8 dt. 27.11.2007, "Per kufinj të niveleve të zhurmave në mjedis specifik", të bazuar në standardet e Organizatës Botërore të Shëndetit (WHO).

MENAXHIMI I MBETJEVE

Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës ka ndërtuar një koncept gjithëpërfshirës të menaxhimit të mbetjeve që përfshin mbetjet e parrezikshme edhe ato të rrezikshme të gjeneruara në aeroport.

Veprimtaritë e Aeroportit mbi menaxhimin e mbetjeve fokusohen kryesisht në zbatimin e programit Ripërdor–Redukto–Riciklo. Ky program ka për synim të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm dhe përputhshmërinë me kuadrin ligjor mjedisor, rregulloret si edhe procedurat e TIA-s.

Koncepti i ndarjes së mbetjeve në burim aplikohet si për materialet e riciklueshme ashtu edhe ato të pariciklueshme, dhe veprimet ndërmerren falë koordinimit të punës së palëve të ndryshme me qëllim rritjen e fuqisë ricikluese dhe uljen e impaktit negativ mbi mjedisin.

Mbetjet e riciklueshme (kartona, plastikë dhe kanaçe alumini, etj.) ruhen përkohësisht në një pajisje presimi mbeturinash të vendosur në vendgrumbullimin e mbetjeve të Aeroportit. Mbetjet e rrezikshme të tilla si vajrat e përdorur grumbullohen në kontenerë të posaçëm për t'u ripërdorur nga kompanitë e licensuara.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, TIA bashkëpunon ngushtë me kompani të licensuara nënkontraktuar për të kryer shërbimin e transportit dhe largimin përfundimtar të mbetjeve të ngurta, atyre të rrezikshme dhe atyre të riciklueshme.

WASTE MANAGEMENT

TIA possesses a comprehensive waste management concept that includes all non-hazardous and hazardous waste generated at the Airport.

TIA undertakes its activities for waste management with special focus on implementation of a Reuse–Reduce–Recycle programme, aiming at sustainable development and ensuring compliance with environmental laws and regulations, as well as its own procedures.

The concept of waste separation at source is used for both recyclable and non-recyclable waste, and the action is promoted in coordination with various stakeholders in order to optimize recycling and reduce environmental impacts.

Recycled waste (cardboard, plastic, aluminium cans, etc.) is stored temporarily at a trash compactor placed at TIA's waste collection site. Hazardous waste, such as used oil, is collected separately in specific containers for re-use by licensed companies.

TIA cooperates continuously with subcontracted licensed companies to perform the transportation service and disposal of solid waste, recyclable and hazardous waste, complying with the legislation in force.

NATURAL ENVIRONMENT

Bird and Pest Management

In the framework of TIA's wildlife action plan consolidated activities in data collection and elimination of bird attractions and controlling measures are undertaken and include the following:

- inspections and checks for uncovered food services and rubbish bins and containers
- improvement in the drainage system, including investment in a new pipeline for discharge of the New (northern) Apron surface water
- modification of vegetation cover within the airfield
- application of predefined bird control measures (e.g. bioacoustics, hunting)
- implementation of the Bird and Pest Management Procedure.

The staff responsible for bird control around the airside area has collected statistics and data and maintained a birds inventory in order to classify the current situation and has implemented appropriate measures for minimizing wildlife activities.

In the context of awareness raising activities different workshops, trainings and meetings are organized with TIA staff, the maintenance contractor, airfield maintenance contractor, etc. The Airport has fulfilled its obligations to implement the Action Plan objectives outside the Airport area in cooperation with local authorities and nearby schools through raising environmental awareness, waste collection and cleaning of the vicinity, aiming to make it less attractive for wildlife.

Landscaping and Gardening

TIA's landscaping and gardening is performed in accordance with the respective plans in order to upgrade and enhance the Airport's landscaping and gardening.

TIA's inventory consists of native and non-native trees, e.g., olive trees, bonsai, palms (*Washingtonia*), linden (*Tilia*), and shrubs (*Vinca major*, *Callistemum*, *Rosmarinus*, *Hypericum*, *Laurus nobilis*), as well as grassy lawns.

The contracted company manages its activities based on a maintenance plan and in accordance with environmental regulations, international standards and TIA's procedures in place.

ENERGY MANAGEMENT

An Energy Management System orientated towards ISO 50001 and based on continuous improvement of energy efficiency, energy saving and carbon reduction, is being implemented by the Airport. The Company's aim is to decrease operational costs and energy consumption per passenger, and decrease negative impacts on the Airport's environment and surroundings in compliance with its Energy Policy.

Conformity with relevant Albanian energy legislation is the basis on which to achieve the targets set in the Energy Management Action Plan, where the measures and actions regarding energy efficiency to be implemented in the short-, mid- and long-term are identified.

Some of the defined internal targets are related, among other things, to reduction in electricity and diesel consumption.



MJEDISI NATYROR

Programi i Menaxhimit të Zogjve dhe Kafshëve të Tjera

Në kuadrin e Planit të Veprimit të Habitave të Botës së Gjallë, Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës ka ndërmarrë veprimtari afatgjata për mbledhjen e të dhënave dhe eliminimin e kushteve tërheqëse për zogjtë që përbëjnë rrezik të mundshëm për avionët. Masat monitoruese dhe parandaluese të ndërmarra përfshijnë:

- inspektimet dhe kontrollet për ushqime të ekspozuara në mjedis apo kosha plehrash, dhe kontenerë të pa mbyllur
- marrjen e masave për përmirësimin e sistemit kullues duke përfshirë investimin në një linjë të re nëntokësore për shkarkimin e ujrave sipërfaqësore të zonës veriore të vendqëndrimit të avionëve
- modifikimin e bimësisë në brendësi të zonës së gjelbëruar
- marrjen e masave të paracaktuara për kontrollin e zogjve (të tilla si bioakustika dhe gjuetia e zogjve)
- zbatimin e Procedurës së Menaxhimit të Zogjve dhe Specieve të Dëmshme.

Stafi përgjegjës për menaxhimin e zogjve në hapësirën ajrore përreth aeroportit ka mbledhur statistika dhe të dhëna dhe ka hedhur çdo të dhënë në një inventar të specieve të zogjve me qëllim njohjen e situatës aktuale dhe marrjen e masave të duhura për të minimizuar aktivitetet e botës së gjallë. Në kuadër të rritjes së aktiviteteve ndërgjegjësuere janë organizuar seminare, trajnime dhe takime me stafin e TIA-s si dhe me pjesëmarrjen e palëve të kontraktuara për mirëmbajtjen e aeroportit.

Aeroporti ka përbushur detyrimet e tij për të vënë në jetë objektivat e planit të veprimit për zonën jashtë territorit të aeroportit në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet lokale dhe shkollat pranë zonës së aeroportit. Këto veprimtari janë bërë të mundura përmes rritjes së ndërgjegjësimit mjedisor, ndërmarrjes së fushatave të pastrimit, mbledhjes së mbeturinave në zonat përreth dhe kthimit të mjedisit në një vend më pak tërheqës për aktivitetin e botës së gjallë.

Peisazhi dhe gjelbërimi

Rregullimi i peisazhit dhe i brezit të gjelbërt të aeroportit kryhet në përputhje me planet respektive me qëllim pasurimin dhe rivlerësimin e peisazhit dhe lulishteve të aeroportit.

Inventari i Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës përfshin varietete pemësh vendase dhe jo vendase të tilla si pemët e ullirit, bonsai, palmat (Washingtonia), pemët e bliirit (Tilia) dhe shkurret të tilla si (Vinca major, Callistenum, Rosmarinus hypericum, Lauma nobilis) si dhe lëndinat me bar.

Kompania e kontraktuar për këtë çështje kryen veprimtarinë e saj bazuar në një plan mirëmbajtjeje dhe në përputhje me rregulloret mjedisore, standardet ndërkombëtare dhe procedurat e TIA-s.



In comparison with 2011 a ten percent reduction in electricity consumption was identified taking into consideration efficiency actions and measures focused on energy savings.

The actions taken so far by TIA with regard to the Energy Saving Action Plan include the following:

- upgrade of a third electrical supply power line (20 kV) serving as back up
- adjustment of power(speed) level of heating and cooling pumps
- adjustment of operating times of fan coils
- adjustment of indoor air temperature per designated rooms
- optimization of the plant's strategic Air Handling Unit
- adjustment of lighting
- energy-efficient illumination
- improvement in Ground Service Equipment (GSE); TIA continuously updates its GSE stock.

The Energy Policy of TIA has been placed at the following locations accessible to the public:

- Terminal building
- Administration building.

The Energy Policy is delivered to TIA staff through e-mail and is also accessible for all staff on the TIA server.

Based on TIA's energy policy and identified training needs different trainings on energy saving issues have been held dealing with staff behaviour and actions taken by operational staff.

In 2012, two trainings were conducted by HOCHTIEF Airport in cooperation with TIA's Quality Environment Health & Safety (QEHS) Department, as follows:

- Awareness Training on Energy Savings, introducing to all Airport staff basic concepts on energy savings and the Energy Management System
- Technical Training on Energy Savings, introducing technical and specialized methodology and concepts on energy savings designed for the Technical Departments and Facility Maintenance Subcontractor.

In order to achieve its objectives and targets related to quality, energy, environment, health & safety and social responsibility, TIA encourages its employees and business partners to be aware and understand their responsibilities. It also requires third parties to manage their environmental, health and safety effects just as TIA does in order to maintain overall performance standards.

AIRPORT CARBON ACCREDITATION

In the framework of its energy policy TIA is committed to not only energy efficiency and energy saving but also reduction of carbon emissions, addressing so the challenges of climate change.

In this regard TIA has joined the ACI Europe initiative Airport Carbon Accreditation scheme, which assesses and recognizes the efforts of airports to manage and reduce their carbon emissions.

Airport Council International Europe is a professional organisation of airport operators and represents more than 400 airports in Europe.

Airport Carbon Accreditation offers a step-by-step process that encourages airports to measure their carbon emissions in a uniform and independent way and promote initiatives to reduce such emissions with the ultimate goal of carbon neutral operations.

MENAXHIMI I ENERGJISË

Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës ka vënë në zbatim sistemin e menaxhimit të energjisë i orientuar sipas standardit ISO 50001 dhe të bazuar në përmirësimin e vazhdueshëm të efikasitetit të energjisë, kursimit të energjisë dhe reduktimit të emetimeve të dioksidit të karbonit. Synimi i kompanisë është që në përputhje me politikën e energjisë të reduktojë kostot operacionale dhe konsumin e energjisë për pasagjer dhe të ulë impaktin negativ që këto të fundit kanë në mjediset e aeroportit dhe përreth tij.

Plani i Veprimit i Sistemit të Menaxhimit të Energjisë është hartuar në përputhje me legjislacionin shqiptar për energjinë dhe përbën bazën për përcaktimin e masave dhe veprimeve afatgjata dhe afatshkurtra të parashikuara të ndërmerren me synim rritjen e efikasitetit të energjisë.

Disa nga objektivat e brendshme të përcaktuara nga TIA përfshijnë reduktimin në konsumin e energjisë elektrike dhe atë të naftës. Masat dhe veprimet e ndërmarra të fokusuar në kursimin e energjisë kanë rezultuar në një ulje prej dhjetë përqind të energjisë elektrike krahasuar kjo me konsumin e vitit 2011.

Disa nga veprimet të lidhura me planin e veprimit të kursimit të energjisë të ndërmarra deri tani përfshijnë:

- rinovimin e një linje të tretë elektrike (20kV) që do të shërbejë si linjë rezervë
- rregullimin e nivelit të fuqisë (shpejtësisë) së pompave për ftohje dhe ngrohje..
- rregullimin e kohës së punës së një pjese të sistemit për ngrohje-ventilim-ftohje-ajër të kondicionuar
- rregullimin e temperaturës së brendshme të ajrit në dhoma të caktuara
- optimizimin e njësive së trajtimit të ajrit në aeroport
- përmirësime në sistemin e ndriçimit
- ndriçim eficient
- përmirësimin e pajisjeve të shërbimit në tokë; TIA vazhdimisht rinovon pajisjet e shërbimit në tokë.

Politika e TIA-s për energjinë është ekspozuar edhe në vendet me akses të gjerë për publikun:

- Terminalët e aeroportit
- Ndërtesa e administratës

Politika e TIAs për energjinë i është shpërndarë me postë elektronike stafit të aeroportit dhe është lehtësisht e aksesueshme nga të gjithë edhe në serverin e TIA-s.

Bazuar në politikën e TIAs për energjinë dhe në identifikimin e nevojave për trajnim për stafin e TIA-s u organizuan trajnime të ndryshme për çështjet e kursimit të energjisë të lidhura ngushtë me sjelljen e stafit dhe shërbimet që kryhen nga stafi operacional.

Në vitin 2012, dy trajnime u drejtuan nga kompania HOCHTIEF Airport në bashkëpunim me Departamentin e Cilësisë, Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë së TIA-s.

Trajnimet u zhvilluan sipas tematikave në vijim:

- Trajnim ndërgjegjësues për kursimin e energjisë, duke i bërë të njohur stafit të Aeroportit konceptet bazë të kursimit të energjisë dhe të funksionimit të sistemit të menaxhimit të energjisë.
- Trajnim teknik mbi kursimin e energjisë me fokus prezantimin e metodologjive dhe njohurive teknike dhe të specializuara mbi kursimin e energjisë. Këto trajnime ishin të jokusuara për stafin e departamenteve teknike dhe nënkontraktorët e angazhuar me mirëmbajtjen në aeroport.

Për të arritur qëllimet dhe objektivat e veta përsa i përket cilësisë, energjisë, mjedisit, shëndetit dhe sigurisë, TIA nxit punonjësit e saj dhe partnerët në biznes drejt ndërgjegjësimit dhe të kuptuarit të këtyre përgjegjësiave administrative dhe sociale. Politikat e TIA-s gjithashtu nxisin palët e treta drejt respektimit të standardeve të mjedisit, shëndetit dhe sigurisë me qëllim ruajtjen e standardeve të përgjithshme të performancës.

AKREDITIMI I AEROPORTIT PËR NIVELIN E EMETIMIT TË DIOKSIDIT TË KARBONIT

Në kuadër të politikës së tij për energjinë, Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës është i angazhuar jo vetëm drejt ruajtjes së efikasitetit të energjisë dhe reduktimit të konsumit të energjisë, por edhe drejt uljes së nivelit të emetimit të dioksidit të karbonit në atmosferë, duke iu përgjigjur në këtë mënyrë sfidave të ndryshmeve klimatike.

Në këtë drejtim, TIA i është bashkuar Këshillit Ndërkombëtar të Aeroporteve(ACI) për Evropën në iniciativën e skemës së Akreditimit të Aeroporteve për Karbonin , e cila ka për qëllim vlerësimin dhe mbështetjen e përpjekjeve nga aeroportet për menaxhimin dhe reduktimin e emetimeve të dioksidit të karbonit në atmosferë.

There are four levels to the process of obtaining accreditation:

- Level 1 Mapping, footprint measurement
- Level 2 Reduction, carbon management towards a reduced carbon footprint
- Level 3 Optimization, third-party engagement in carbon footprint reduction
- Level 4 Neutrality, carbon neutrality for direct emissions through offsetting.

In 2012, TIA, with support of HOCHTIEF Airports, assessed and calculated the carbon footprint of CO₂ emissions at Tirana International Airport. Calculation are based on amounts of electricity, heat, fuels consumed, respective emission factors.

In compliance with ACI Europe’s Airport Carbon Accreditation Scheme, Level 1 “Mapping”, and Greenhouse Gas Protocol, energy emission sources at the Airport are classified into Scope 1—owned and controlled sources of direct emissions such as heating plant, Ground Support Equipment, emergency power and fleet vehicles—and Scope 2—indirect emissions such as purchased electricity.

CO₂ emissions in 2011

Parameters for 2011	Annual emissions (tons of CO ₂)
Scope 1: Energy direct emissions	963.76
Scope 2: Energy indirect emissions	73.62
Total	1,037.38

The total carbon footprint for TIA in 2011 amounted to 1,037 tons of CO₂. As all of its indirect emissions are produced by electricity consumption—mainly provided by Albania’s hydropower plants—TIA’s Scope 2 carbon footprint was relatively small compared to other airports of a similar size.

The determination of the carbon footprint of the Airport was verified by an independent third party before accreditation was issued.

In January 2013, Tirana International Airport became Airport Carbon Accredited at Level 1, Mapping.

TIA is committed to using its best endeavours to reach the subsequent levels of Reduction, Optimization and Neutrality in the years to come.

Stakeholder Confidence

Airport Carbon Accreditation has been received very positively in the frame of efforts of the Government of Albania to strengthening the country’s approach to climate action by developing and implementing a National Climate Change Strategy in line with that of the EU, and with specific objectives. The efforts of TIA are quoted as a very good example for other businesses in Albania.

Accreditation has helped TIA gain public recognition of its achievements and milestones reached in the development of management practices targeting carbon emissions reduction. Such achievements give our customers, stakeholders and third parties heightened confidence and are testimony to TIA’s commitment to sustainable use of resources, energy efficiency optimization and cost reduction.

TIA is aware that the results achieved so far and the foreseen future actions can continue to be successfully implemented only through a participatory approach and definition of clear responsibilities for all parties involved.



Këshilli Ndërkombëtar Evropian i Aeroporteve është një organizatë profesionale dhe e kualifikuar për operatorët e Aeroporteve e cila përfaqëson më shumë se 400 aeroporte në mbarë Evropën.

Skema e akreditimit të aeroporteve për nivelin e emetimit të dioksidit të karbonit në atmosferë përbën një proces që duhet të ndiqet hap pas hapi nga aeroportet dhe i nxit ato drejt matjeve të emetimeve të dioksidit të karbonit në një mënyrë standarde dhe të pavarur dhe promovon iniciativa për të reduktuar emetime të tilla me qëllimin që të arrijë objektivin final i cili consiston në neutralizimin e nivelit të dioksidit të karbonit.

Procesi i akreditimit kalon nëpër katër faza:

- Niveli i parë: Përcaktimi i gjurmës së emetimit të dioksidit të karbonit në aeroport
- Niveli i dytë: Reduktimi, menaxhimi i nivelit të dioksidit të karbonit drejt minimizimit të gjurmës së dioksidit të karbonit në aeroport
- Niveli i tretë: Optimizimi, përfshirja e palëve të treta në reduktimin e gjurmës së dioksidit të karbonit në aeroport
- Niveli i katërt: Neutralizimi, për emetimet direkte të dioksidit të karbonit përmes adoptimit të një qasjeje kompensuese.

Në vitin 2012, TIA me mbështetjen e kompanisë HOCHTIEF AirPort vlerësoi dhe përlogariti nivelin e gjurmës së dioksidit të karbonit të emetuar, në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës. Llogaritjet janë bazuar në sasinë e konsumuar të energjisë elektrike, karburantit si dhe energjisë së prodhuar për ngrohje dhe koeficientëve të tyre përkatës të emetimit.

Në përputhje me skemën Akreditimit të Aeroporteve për Karbonin të ACI- Evrope specifikisht nivelit të parë të kësaj skeme (përcaktimit të gjurmës), dhe në përmbushje të Protokollit të Gazeve që shkaktajnë efektin serë, burimet e emetimit të energjisë në aeroport klasifikohen në dy kategori (fusha): Kategoria e parë - emetime të drejtëpërdrejta të kontrolluara të energjisë nga burime të tilla si impianti i ngrohjes, gjeneratorët e emergjencës, pajisjet mbështetëse të shërbimit në tokë, dhe automjetet aeroportuale; Kategoria e dytë - emetime jo të drejtëpërdrejta të energjisë nga burime të tilla si energjia elektrike e blerë.

Niveli i emetimit të dioksidit të karbonit (CO₂) në vitin 2011

Parametrat për vitin 2011	Niveli vjetor i emetimit të dioksidit të karbonit (CO ₂ në ton)
Kategoria 1: Emetime të drejtëpërdrejta të energjisë	963.76
Kategoria 2: Emetime jo të drejtëpërdrejta të energjisë	73.62
Totali	1,037.38

Për vitin 2011, gjurma totale e dioksidit të karbonit në Aeroport u llogarit rreth 1,037 ton dioksid karboni. Meqënëse thuajse të gjitha emetimet e dioksidit të karbonit jo të drejtëpërdrejta prodhohen nga konsumi i energjisë elektrike e siguruar kryesisht nga hidrocentralet, Kategoria 2 e TIA-s është relativisht e vogël krahasuar me nivelin e kësaj gjurme në aeroporte të përmasave të ngjashme.

Niveli i gjurmës së dioksidit të karbonit në Aeroport u verifikua nga një palë e tretë para se të përfundonte zyrtarisht procesi akreditimit.

Në janarin e vitit 2013, Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës u bë aeroport i akredituar për emetimin e dioksidit të karbonit në atmosferë sipas nivelit 1 të skemës së akreditimit, atij të përcaktimit të gjurmës.

TIA është e angazhuar të vazhdojë përpjekjet në drejtim të arritjes së niveleve të mëtejshme në skemën e akreditimit të dioksidit të karbonit në atmosferë për optimizimin, reduktimin dhe neutralizimin në vitet në vijim.

Besimi i Aktorëve dhe Grupeve të Interesit

Akreditimi i Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës përsa i përket emetimit të nivelit të dioksidit të karbonit në atmosferë është pritur shumë pozitivisht në kuadrin e përpjekjeve të qeverisë shqiptare për të fuqizuar qëndrimin në rang kombëtar ndaj veprimeve klimaterike me anë të zhvillimit dhe zbatimit të një Strategjie Kombëtare për Ndryshimet Klimaterike, në linjë me strategjinë evropiane për këtë çështje si dhe me objektiva specifike. Iniciativat dhe arritjet e TIA-s në këtë drejtim përbëjnë një shembull shumë të mirë për të gjitha bizneset e tjera në Shqipëri.

Akreditimi e ka ndihmuar TIA-n të bëhet i njohur për arritjet e veta në fushën e zhvillimit të praktikave të menaxhimit mbi reduktimin e emetimit të dioksidit të karbonit në atmosferë. Arritje të tilla i japin klientëve tanë, aktorëve, dhe grupeve të interesit, palëve të treta një besim të theksuar dhe janë dëshmi e angazhimit të Kompanisë në drejtim të përdorimit të qëndrueshëm të burimeve, efijencës në përdorimin e energjisë dhe uljes së kostove.

TIA është i ndërgjegjshëm që rezultatet e arritura deri më tani dhe masat e parashikuara për t'u ndërmarrë në të ardhmen mund të vihen në jetë në mënyrë të suksesshme vetëm me anë të një qasjeje pjesëmarrëse dhe vetëm pas përcaktimit të përgjegjësive të qarta për të gjitha palët e përfshira.

Health and Safety

Shëndeti dhe Siguria



Operational Safety

Most important among Airport operations is the assurance of high standards of safety and health for all TIA customers and employees. Aiming to provide a safe environment in compliance with its values, and concern with standards and regulation requirements, TIA ensures that health and safety issues are tackled carefully. The company has established and is implementing an Employee Manual, which lays out all relevant health and safety issues and standards, aiming to make all TIA employees aware of all the requirements and their obligations to fully comply with them.

Occupational Health & Safety

In order to ensure the health and safety of its employees and provide them with a safe working environment, TIA is implementing all necessary measures in full compliance with regulations in place to prevent all risks to occupational health and safety. The same is requested of TIA's contractors, who also have to ensure the occupational health and safety of their employees.

The subcontractors have the obligation to provide TIA the evidence and records of the checks that they carry out independently with regard to workplaces, and to ensure that any premises, plant, equipment, and substances they provide for TIA and others to use are safe and without risks to health. Every worker at the Airport has a duty to take reasonable care for their own health and safety and that of all other persons who might be affected by what they do.

Airside Safety and Human Factors Awareness Training was organized for all TIA staff in 2012, aiming to increase safety awareness and to ensure that all staff members are aware of their roles and responsibilities, the basic concepts of human factors, and their relationship to safety and human performance issues at the Airport, compliance with safety procedures & regulations, and the main hazards while performing daily operations.

Medical health checks of all TIA and subcontractors' staff are carried out periodically in specialized health institutions. All records and medical examinations are kept properly for each employee and in compliance with all requirements and legislation in force.

Siguria Operacionale

Një ndër çështjet më të rëndësishme për operimin në Aeroport është sigurimi i standardeve të larta të sigurisë dhe të shëndetit për të gjithë klientët dhe punonjësit në TIA. Duke synuar që të ofrojë një mjedis të sigurtë në përputhje me vlerat e shpallura dhe të operojë në përputhje me standardet dhe rregulloret ligjore, TIA angazhohet të monitorojë trajtimin e kujdesshëm të çështjeve të shëndetit dhe sigurisë. Kompania ka hartuar dhe është në fazën e zbatimit të një manuali të punonjësve, që paraqet të gjitha standardet e shëndetit dhe të sigurisë dhe që ka për synim ndërgjegjësimin e punonjësve të aeroportit për kërkesat dhe përgjegjësitë e tyre që burojnë nga këto standarde dhe rregullore ligjore.

Shëndeti dhe Siguria në Punë

Në mënyrë që të sigurojë shëndetin dhe sigurinë në punë të të gjithë punonjësve dhe t'u sigurojë atyre një mjedis pune të sigurtë, TIA ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në drejtim të parandalimit të të gjithë risqeve për shëndetin dhe sigurinë në punë. E njëjta gjë kërkohet edhe nga palët e kontraktuara nga TIA, të cilët gjithashtu duhet të sigurojnë shëndetin dhe sigurinë në punë të punonjësve të tyre.

Nënkontraktorët kanë detyrim të kryejnë vetë kontrolle dhe t'i demonstronjë TIA-s se vendi i tyre i punës dhe ndërtesat, impiantet, pajisjet dhe substancat në përdorim janë të sigurta dhe pa asnjë rrezik për shëndetin. Çdo punonjës në Aeroport ka detyrimin të tregojë kujdes për shëndetin dhe sigurinë e tij dhe të gjithë personave që mund të ndikohen nga ajo çfarë ata bëjnë.

Trajnime mbi sigurinë në zonën ajrore dhe për ndërgjegjësimin e faktorit njerëzor u organizuan për të gjithë stafin e Aeroportit gjatë vitit 2012. Qëllimi i këtyre trajnimeve ka qenë rritja e ndërgjegjësimin të stafit për çështje të sigurisë dhe zgjerimi i njohurive të tyre për rolet, përgjegjësitë dhe konceptet bazë të faktorit njerëzor si dhe ndërthurja midis sigurisë në Aeroport me performancën njerëzore, apo ndikimi i kësaj performace në çështjet e sigurisë, në zbatimin e procedurave për sigurinë dhe në përputhshmërinë me rregulloret në fuqi, duke bërë të njohur gjithashtu edhe rreziqet kryesore gjatë operimeve të përditshme.

TIA staff, including seasonal staff, are provided with uniforms appropriate to the work they perform and with personal protection equipment in accordance with European standards, as well as the TIA Uniform Manual and updated TIA Airside Safety Instructions. Staff are made aware of the importance of the proper use of equipment and safety instructions and proper implementation of TIA's standards and procedures.

In order to provide a healthy environment for all staff and customers, in compliance with health and safety legislation, the following measurements of parameters were carried out in 2012:

- main microclimate parameters: CO₂ gas, relative humidity (RH), air temperature, air movement and light intensity, and concentration of PM2.5 that impact directly human health
- noise inside the passenger terminal
- air quality during operation of the Waste Water Treatment Plant: CO, Volatile Organic Compounds (VOCs), hydrogen sulphide (H₂S), oxygen (O₂)
- exposure of employees to ionizing radiation during the course of their daily work.

The results of the measurements and continuous monitoring carried out during 2012 regarding occupational, health and safety issues show that the relevant standards are respected and a proper working environment is provided for all staff, third parties and TIA customers.

Construction Site Health & Safety

The construction activities carried out at TIA during 2012 included the following:

- taxiways repair works
- new pipeline for discharge of the New (northern) Apron surface water
- asphaltting of the vehicle/equipment parking area at Gate A
- new building at the existing Main Station for integration and upgrade of the third electricity power line (20 kV) serving as back up.

Compliance with TIA's Construction Monitoring Programme for Environmental Protection is provided through continuous monitoring of construction works by respective TIA structures in order not only to ensure that the companies are committed to carrying out the construction projects, but also to accomplish at the same time all environmental, health and safety standards and regulations in force.

TIA constantly implements mitigation measures with the aim of avoiding or preventing land contamination, air pollution or water pollution and minimising noise levels resulting from construction activities. In this regard observations and inspections are carried out to check implementation of all the environmental, health, safety and security procedures.





Kontrolle mjekësore në institucione të specializuara të shëndetit kryhen në mënyrë periodike për të gjithë stafin e TIA-s dhe nënkontraktorëve të saj. Në përputhshmëri të plotë me gjithë kërkesat dhe legjislacionin në fuqi, dokumentacioni shëndetësor dhe analizat mjekësore të secilit punonjës arkivohen përkatësisht dhe me kujdes.

Stafi i TIA-s, përfshi këtu edhe stafin sezonal, pajisen me uniforma të përshtatshme për punën që ata kryejnë, si dhe me pajisje personale mbrojtëse, të cilat janë në përputhje me standardet evropiane, kërkesave që vijnë nga manuali i uniformave të TIA-s apo nga udhëzimet e përditësuara të TIA-s për sigurinë në zonën ajrore. Stafi ndërgjegjësohet mbi rëndësinë e përdorimit të duhur të pajisjeve dhe instruksioneve mbi sigurinë si dhe atë të zbatimit të duhur të standardeve dhe procedurave të TIA-s.

Me qëllim ofrimin e një mjedisi të shëndetshëm për të gjithë stafin dhe klientët dhe në përmbushje të legjislacionit mbi shëndetin dhe sigurinë, u ndërmorën matjet e parametrave të mëposhtëm për vitin 2012:

- matja e parametrave kryesorë mikroklimatikë, gazi i dioksid karbonit (CO_2), lagështira relative (RH), temperatura e ajrit, shpejtësia e lëvizjes së ajrit, intensiteti i dritës, përqendrimi i grimcave të pluhurit në ajër $\text{PM}_{2.5}$, të cilat kanë ndikim të drejtëpërdrejtë mbi shëndetin njerëzor.
- matja e nivelit të zhurmave në brendësi të terminalit të pasagjerëve
- matja e cilësisë së ajrit gjatë funksionimit të impiantit të trajtimit të ujrave të ndotura, monoksidit të karbonit (CO), përbërjeve organike avulluese, sulfurit të hidrogjenit (H_2S) dhe oksigjenit (O_2).
- matja e nivelit të ekspozimit të nëpunësve ndaj rrezatimit jonizues gjatë ditës së tyre të punës .

Rezultatet e matjeve dhe gjetjet e monitorimit të vazhdueshëm të kryer gjatë vitit 2012 për çështje të sigurisë dhe shëndetit në punë, dëshmojnë se standardet respektohen dhe një mjedis pune i përshtatshëm ofrohet për të gjithë stafin, palët e treta dhe klientët e TIA-s.

Shëndeti dhe Siguria në Sheshet e Ndërtimit

Projektet e ndërtimit të ndërmarra nga TIA gjatë vitit 2012 përfshijnë:

- rikonstrukcionin e rrugëve lidhëse ku lëvizin avionët
- ndërtimin e një linje të re kanalizimesh për shkarkimin e ujrave sipërfaqësore në pjesën veriore të aeroportit
- asfaltimin e zonës së parkimit të mjeteve tek Porta A
- një ndërtesë të re pranë stacionit qendror ekzistues për integrimin dhe përmirësimin e një linje të tretë elektrike (20kV) që do të shërbejë si linjë rezervë

Përputhshmëria në zbatimin me përpikmëri të programit të monitorimit të ndërtimit të TIA-s për mbrojtjen mjedisore mundësohet përmes një monitorimi të vazhdueshëm të punimeve nga strukturat e Kompanisë. TIA sigurohet, jo vetëm që kompanitë të angazhohen në përmbushjen e projekteve ndërtimore, por gjithashtu edhe që punimet e tyre të kryhen në respekt të të gjitha standardeve dhe legjislacionit në fuqi mbi mjedisin, shëndetin dhe sigurinë.

TIA ndërmerr herë pas here masa lehtësuese me qëllim shmangien apo parandalimin e ndotjes së terrenit, reduktimin e ndotjes së ajrit apo të ndotjes së ujrave dhe me synim minimizimin e nivelit të zhurmave të shkaktuara gjatë punimeve. Në këtë aspekt kryhen vëzhgime dhe kontrolle të herëpashershme me qëllim monitorimin e zbatimit të të gjithë kuadrit ligjor dhe procedural mbi mjedisin, shëndetin, dhe procedurat e sigurisë (safety and security).

Customers and
Social aspects

Klientët dhe
Aspekte sociale



The mission of TIA to develop one of the top companies in Albania is based on the belief that the people and community who work, pass through or are attached to the Airport are key to the company's success and future growth. Thus, ensuring provision of top quality services and meeting the demands and achieving the satisfaction of all Airport customers—passengers, visitors, meeters and greeters, airlines, service providers, third parties, the local community, and the general public—constitutes one of TIA's main commitments.

Many efforts have been undertaken over the years and are still being undertaken to achieve this goal, through maintaining on-going evolution of the high level quality of services we deliver and the overall top quality and performance of Airport operations. Such efforts are taken in the framework of the TIA system established for managing quality and performance issues with clearly defined objectives and targets in the Quality Policy. This system is orientated towards and implemented in full compliance with national and international standards and requirements.

In order to evaluate the satisfaction of the services delivered to TIA customers and to understand their perceptions in this regard, the Company has introduced various tools and methods to measure and monitor services performance. Some standard methodologies applied in today's marketplace and which TIA has used are presented below, along with the results deriving from them for the year 2012. The findings demonstrate the success with both the implementation of the methods and also in achieving the goal of maintaining customer satisfaction.

Misioni i TIA-s për t'u shndërruar në një nga kompanitë kryesuese në Shqipëri bazohet në besimin se njerëzit dhe komuniteti të cilët punojnë, lëvizin përmes Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës apo i janë bashkëngjitur stafit të tij, janë çelësi i suksesit dhe rritjes së mëtejshme të kompanisë në të ardhmen. Në këtë mënyrë, sigurimi i shërbimeve cilësore, përmbushja e kërkesave të klientëve dhe rritja e kënaqësisë së tyre përbëjnë disa prej angazhimeve kryesore të Kompanisë. Klientët e TIA-s përfshijnë pasagjerët, vizitorët, personat shoqëruar të pasagjerëve, linjat ajrore, ofruesit e shërbimeve, palët e treta, komunitetin lokal dhe publikun e gjerë.

Shumë përpjekje janë ndërmarrë gjatë këtyre viteve dhe po ndërmerren ende sot për të arritur këtë qëllim bazuar në rritjen e vazhdueshme drejt nivelit më të lartë të cilësisë së shërbimeve dhe duke synuar ruajtjen e cilësisë dhe performancës së përgjithshme të operimit në Aeroport. Këto përpjekje janë ndërmarrë në kuadër të politikave të TIA-s për menaxhimin e cilësisë dhe performancës, me plane dhe objektiva të mirëpërcaktuara në Politikën e Cilësisë. Ky është një sistem i mirë-orientuar i cili operon në përputhje me standardet dhe kriteret kombëtare dhe ndërkombëtare.

Për të vlerësuar nivelin e kënaqësisë për shërbimet e ofruara klientëve të TIA-s, dhe për të kuptuar perceptimet e tyre lidhur me to, kompania ka adoptuar mjete dhe metodologji të ndryshme të matjes dhe monitorimit të performancës së shërbimeve. Disa nga metodologjitë standarde të aplikuara në tregun e sotëm të punës dhe të adoptuara nga TIA, paraqiten më poshtë së bashku me rezultatet përkatëse për vitin 2012. Gjetjet dëshmojnë suksesin në zbatimin e këtyre metodologjive dhe arritje në ruajtjen e të njëjtave nivele të kënaqësisë së klientëve.

TIA Customer Satisfaction Survey

The main sources of feedback applied by TIA to identify passenger opinions on services offered and assessment of the quality of services, obtained through comparing customer expectations and perceived performance, is the Customer Satisfaction Survey.

The main aim of this tool is to confirm that TIA facilities, equipment and staff are always available to operate all the functions at top standard in the passenger terminal and to demonstrate the Company's ability to consistently provide a service that meets customer requirements.

The Satisfaction Survey is performed on an annual basis at the beginning of each year, and is carried out by an independent company specialized in market research.

The sample size was set at 1,000 interviews. Thus, each year, 1,000 passengers, selected by gender, age and nationality, are interviewed in the Departure Lounge in the passenger terminal. The whole process, from entry to the Airport to departure and arrival, is encompassed aiming to obtain the impression of passengers of their experience of the Airport. The decision to interview such a large number of passengers relative to the size of the Airport was taken to ensure a sample size sufficiently large to be useful to gain understanding of customer satisfaction issues in great detail, perform detailed and in-depth analysis, and provide a very good basis for necessary actions and measures aiming to maintain excellent customer satisfaction.


The overall level of customer satisfaction deriving from the results of the Customer Satisfaction Survey 2012 is generally in the range "satisfied" to "very satisfied". It is therefore clear that the quality of services and facilities offered by TIA remains high, and in some areas higher scores were recorded than in the previous survey.

At the end of each Survey a workshop is organized for the TIA management team for presentation of the Survey findings and conclusions, including overall level of satisfaction compared to previous years. The aim is to discuss and analyse in more detail the level of satisfaction, the services delivered and the airport performance, in order to prioritize improvements and investments that correspond to the practical needs and expectations of TIA customers.

Comment Cards

The comment cards placed in the passenger terminal and available also on the TIA website are a useful tool for receiving comments, suggestions and opinions of passengers and other visitors to the Airport in regard to all services provided by TIA, and for receiving input on their needs and expectations. TIA deals carefully with all collected comments, by taking into consideration every passenger voice, and which are evaluated by designated TIA management staff. All received opinions, suggestions and problems raised are assessed with priority by TIA in regard to each case in order to provide also a solution or appropriate guidelines to the interested person, whether flying via the Airport or not, and to other interested parties, institutions and bodies.





Studimi mbi Kënaqësinë e Klientëve të TIA-s

Burim kryesor për vlerësimin e opinionit të klientëve mbi shërbimet e ofruara nga TIA dhe cilësinë e këtyre shërbimeve, bazuar në një qasje krahasuese të pritshmërive të klientëve dhe perceptimit nga ana e tyre të performancës, është Studimi mbi Kënaqësinë e Klientëve.

Qëllimi kryesor i këtij instrumenti është të konfirmojë që facilitetet, pajisjet dhe stafi i TIA-s janë përherë të disponueshme për të ofruar të gjitha shërbimet në terminalin e pasagjerëve në përputhje me standardet më të mira dhe të provojë që Kompania siguron në mënyrë të vazhdueshme që shërbimet e ofruara përmbushin kërkesat e klientëve.

Studimi mbi Kënaqësinë e Klientëve zhvillohet mbi bazë vjetore në çdo fillim viti dhe ndërmerret nga një kompani e pavarur e specializuar në studime të tregut.

Studimi bazohet në intervistimin e 1000 pasagjerëve. Në këtë mënyrë, çdo vit intervistohen 1000 pasagjerë, të përzgjedhur sipas gjinisë, moshës dhe kombësisë, në zonën e nisjeve të terminalit të pasagjerëve. Intervistuesve u kërkohet opinioni për të gjithë procesin duke përfshirë hyrjen në aeroport, nisjen apo edhe mbërritjen, me qëllim përfitim të një perceptimi sa më gjithëpërfshirës të pasagjerëve mbi përvojat e tyre në Aeroport. Vendimi për të intervistuar një numër kaq të madh pasagjerësh krahasuar me përmasat e aeroportit, është ndërmarrë me qëllim përfitim të një vlerësimi sa më të gjerë dhe të detajuar të çështjeve mbi nivelin e kënaqësisë së klientëve. Ky lloj vlerësimi mundëson kryerjen e një analize të detajuar dhe të thellë të situatës, e cila më pas shërben si orientim në përcaktimin e veprimeve dhe masave të nevojshme për t'u ndërmarrë me qëllim ruajtjen e një niveli të shkëlqyeshëm të kënaqësisë së klientëve.

Në bazë të gjetjeve të Studimit mbi Nivelin e Kënaqësisë së Klientit për 2012, cilësia e shërbimeve të ofruara nga TIA varion në përgjithësi nga "e kënaqshme" në "shumë e kënaqshme". Është i qartë fakti që cilësia e shërbimeve dhe faciliteteve të ofruara nga TIA vazhdon të jetë e lartë, me rezultate relativisht më të larta krahasuar me ata të studimit të mëparshëm.

Pas nxjerrjes së rezultateve të çdo studimi, organizohet një seminar për stafin menaxherial të TIA-s për prezantimin e gjetjeve dhe konkluzioneve të studimit, përfshirë edhe një analizë krahasuese të nivelit të kënaqësisë së klientëve gjatë viteve. Qëllimi i këtij seminari është të diskutojë dhe të analizojë më në thellësi nivelin e kënaqësisë së klientëve, shërbimet e ofruara dhe performancën e aeroportit në tërësi me synim prioritizimin e përmirësimeve dhe investimeve të nevojshme për t'u ndërmarrë në përputhje me nevojat dhe pritshmëritë e klientëve të TIA-s.

Fletët e Përshtypjeve

Fletët e përshtypjeve të vendosura në terminalin e pasagjerëve, gjithashtu të aksesueshme edhe në faqen e internetit të TIA-s, janë një instrument i rëndësishëm për të mundësuar komentet, sugjerimet dhe opinionet e pasagjerëve dhe vizitorëve të aeroportit në lidhje me shërbimin e ofruar nga TIA, dhe një metodologji e mirë për mbledhjen e të dhënave mbi nevojat dhe pritshmëritë e tyre.

Përfaqësuesit e TIA-s i kushtojnë vëmendje zërit të secilit pasagjer dhe shqyrtojnë e vlerësojnë me kujdes të gjitha komentet e mbledhura. Të gjitha opinionet, sugjerimet dhe problemet e ngritura shqyrtohen me prioritet nga stafi menaxherial i TIA-s, me qëllim ofrimin e zgjidhjeve apo udhëzimeve të duhura personave të interesuar, qofshin këta pasagjerë që kalojnë nëpërmjet aeroportit apo vizitorë, përfshirë këtu edhe palëve të tjera, institucioneve apo organizmave të interesuara.

Pyetësorët për Linjat Ajrore dhe Shërbimet e Ngarkesave Ajrore, Takimet me Palët e Treta

Nisur nga fakti që klientët kryesorë të Aeroportit dhe ofruesit kryesorë të shërbimeve për pasagjerët janë linjat ajrore, kompania është e angazhuar t'i ofrojë atyre shërbime të cilësisë së lartë me synim

Airline and Cargo Questionnaires, Meetings with Third Parties

Due to the fact that TIA's main customers providing services to passengers are Airlines, the Company is committed to ensuring them high quality services, maintaining performance standards on services delivered and meeting continuously their demands. A useful tool that TIA has provided in order to obtain a complete overview of the performance and satisfaction with regard to the services and facilities provided is the Airline Questionnaire. Responses to this questionnaire contain the information necessary for better evaluation and establishment of further actions and priorities towards provision of higher quality of services.

Another important group of TIA customers are those providing and requesting cargo and mail services at the Cargo Terminal. Knowing customer demands and expectations in regard to air cargo handling enables TIA to take further steps in the right direction in order to become more attractive for local business, operating agencies, shippers, logistics enterprises, airlines and other operators, and to strengthen the development of cargo and mail operations in the future.

To obtain direct opinions and feedback on operational issues and the level of services delivered, on-going meetings are organised between TIA and representatives of all Airport Third Parties. TIA management analyses the information and data and identifies the necessary actions to be undertaken in order to achieve the expected results.

SOCIAL AND COMMUNITY PROJECTS

Tirana International Airport encourages individual action and shared responsibility towards the environment. The Company takes the view that one of its main duties is to make the local community near the Airport, and further afield, as well as its staff, consider the environment. TIA's business activities and services aim to maximize the social, economic and environmental benefits in the broader Airport region. In this regard, the Company has demonstrated itself to be an important contributor to the overall well-being of the community in the area around the Airport.

TIA has set out quality and environment, health and safety policies and programmes and has taken all measures to meet its commitment towards customers, employees, the community, stakeholders and others.

Promotion of public transport in cooperation with stakeholders is one activity that directly contributes to reducing emissions not only in the vicinity of the Airport but also in the wider context in Tirana and further afield, and to facilitate access to the Airport for passengers, visitors and staff. There is a public transport bus between the Airport and Tirana city centre, as well as shuttle buses for TIA employees, main contractors (maintenance and security) employees and domestic Airline employees, reducing thus the use of private cars.

Another measure in this regard is the prohibition or restriction of use by trucks of access roads to and from the Airport.





përbushjen e vazhdueshme të kërkesave të tyre dhe ruajtjen e standardeve të performancës. Një instrument shumë i frytshëm i përdorur nga TIA për të përfutur një vështrim sa më të gjerë të performancës dhe nivelit të kënaqësisë ndaj shërbimeve dhe faciliteteve të ofruara, është pyetësori i linjave ajrore. Opinioni i ofruar në sajë të këtij pyetësori përmban gjithë informacionin e nevojshëm për një vlerësim me të mirë në ndërmarrjen e veprimeve të mëtejshme dhe vendosjen e prioriteteve me synim ofrimin e shërbimeve të një cilësie të lartë.

Një grup tjetër i rëndësishëm i klientëve të TIA-s janë ofruesit dhe kërkuesit e shërbimeve për ngarkesat ajrore (kargo) dhe dërgesat postare në terminalin e kargos. Njohja e kërkesave dhe pritshmërive të klientëve për çështjet e operimit me ngarkesat ajrore, bën të mundur që TIA të ndërmarrë hapa të matur të mëtejshëm me qëllim kthimin e saj në një kompani më tërheqëse për bizneset lokale, agjencitë operuese, transportuesit e mallrave, ndërmarrjet logjistike, linjat ajrore dhe operatorët e tjerë, dhe për të fuqizuar zhvillimin e shërbimeve të ngarkesave ajrore dhe dërgesave postare në të ardhmen.

Për të përfutur opinione të drejtëpërdrejta dhe për të marrë vlerësimin mbi çështjet operacionale dhe nivelin e shërbimeve të ofruara, organizohen takime të herëpashershme ndërmjet përfaqësuesve të TIA-s dhe përfaqësuesve të të gjitha palëve të treta të aeroportit. Stafi menaxherial i TIA-s analizon informacionin dhe të dhënat si dhe identifikon veprimet e nevojshme për t'u ndërmarrë me qëllim arritjen e rezultateve të pritshme.

PROJEKTET SOCIALE DHE KOMUNITARE

Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës nxit ndërmarrjen e veprimeve individuale dhe ndarjen e përgjegjësi-ve mes aktorëve për çështjet e ruajtjes së mjedisit. Kompania përcjell bindjen që një ndër detyrat e saja kryesore është të ndërgjegjësojë komunitetin përreth aeroportit dhe në terrenin rrethues të tij si edhe stafin e tij për të marrë në konsideratë dhe më tej respektuar mjedisin. Është synim i TIA-s të kontribuojë në maksimizimin e përfitimeve sociale, ekonomike dhe mjedisore për zonën e aeroportit dhe më gjerë. Në këtë drejtim Kompania ka demonstruar në vazhdimësi rolin e saj si një kontribues i rëndësishëm për mirëqënien e komunitetit në zonën përreth Aeroportit.

TIA ka vënë në zbatim politika dhe programe të cilësisë, mjedisit, shëndetit dhe sigurisë si dhe ka ndërmarrë veprimet e duhura për të përbushur angazhimet e marra ndaj klientëve, punonjësve, komunitetit, grupeve të interesit dhe të tjerëve.

Promovimi në bashkëpunim me grupet e interesit i përdorimit të transportit publik, kontribuon në mënyrë direkte në uljen e nivelit të shkarkimeve të gazrave në atmosferë jo vetëm në afërsi të aeroportit por edhe në kontekstin më të gjerë të qytetit të Tiranës dhe më tej, si dhe në lehtësimin e aksesit në aeroport për pasagjerët, vizitorët dhe stafin. Një linjë autobuzi transporti publik lidh Aeroportin me qendrën e Tiranës. Gjithashtu ka autobuzë të dedikuara për transportin e punonjësve të TIA-s, punonjësit e kontraktorëve kryesorë të TIA-s (mirëmbajtjes dhe sigurisë), dhe punonjësit e linjave ajrore përfshirë dhe atyre vendase, duke reduktuar në këtë mënyrë përdorimin e mjeteve private të transportit.

Një masë tjetër e ndërmarrë në këtë kuadër është ndalimi apo kufizimi i qarkullimit të kamionave në rrugëkalimet në drejtim të dhe prej aeroportit.

Social activities and
airport main events

Aktivitetet sociale dhe
ngjarjet kryesore





March 2012

From 7–11 March 2012, Tirana International Airport (TIA) once again was present at the International Travel Trade Show in Berlin (ITB). More than 170,000 visitors, including 108,000 trade visitors, were present at this year's show, along with more than 10,000 exhibitors from 180 countries.

April 2012

On 27 April 2012, Tirana International Airport (TIA) held its first ever Airport Run. The activity gathered together all those working at the Airport, participating in an event that encouraged both team spirit and the idea of competition.

Mars 2012

Në datat 7–11 Mars 2012, TIA mori pjesë në një Ekspozitën Ndërkombëtare të Udhëtimit në Berlin (ITB). Më shumë se 170,000 vizitorë, duke përfshirë 108,000 vizitorë për tregëti, ishin të pranishëm në këtë ekspozitë, së bashku me 10,000 ekspozues nga 180 vende.

Prill 2012

Me 27 Prill 2012, Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës organizoi maratonën e tij të parë. Aktiviteti mbledhi së bashku të gjithë njerëzit që punojnë aeroport në një eveniment që inkurajonte si shpirtin e skuadrës edhe atë të garës.

Gusht 2012

Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës zgjeroi gamën e shërbimeve që ofrohen në brendësi të terminalit të pasagjerëve me shtimin

August 2012

Tirana International Airport (TIA) offered an addition to the services it provides inside the terminal with the opening of an Office for Tourism Services. At the initiative of Albania's Ministry of Tourism, Culture, Youth and Sports, and sponsored by the Turkish International Cooperation and Development Agency (TIKA), in collaboration with TIA, the service is available for tourists since 6 August 2012.

August 2012

In August 2012 TIA obtained the renewal of the Environmental Permit for Waste Water Treatment Plant from the National Licensing Centre.

e një zyre për shërbime turistike. Me iniciativën e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, dhe sponsorizuar nga Agjencia Ndërkombëtare Turke e Bashkëpunimit dhe Zhvillimit TIKA, ky shërbim është vënë në dispozicion të turistëve që me datën 6 gusht 2012.

Gusht 2012

Në gushtin e vitit 2012, Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës mori nga qendra kombëtare e licensimit (QKL) lejen mjedisore të rinovuar për trajtimin e ujrave të ndotura.

Tetor 2012

Me 28 Tetor 2012, Air One një kompani me kosto të ulët pjesë e grupit Alitalia, inauguroi një itinerar të ri nga dhe në drejtim të Tiranës. Destinacioni i ri i mirëpritur është Venecia, një ndër atraksionet turistike botërore.

October 2012

On 28 October 2012, Air One, a low-cost airline that is part of Alitalia Group, inaugurated a new route at Tirana International Airport (TIA). The new and welcomed destination was Venice, one of the world's major tourist destinations.

November 2012

In November, Tirana International Airport (TIA) celebrated the 100 years of independence of the Albanian state. The colours of the national flag have been placed throughout the terminal building, warmly welcoming all of the Airport's passengers. The terminal façade was dressed also in a huge Albanian flag, warmly dedicated to this important milestone for the country. Meanwhile, all those passing close to the terminal have been attracted by a red vintage aircraft Antonov 2, brought to TIA from the Kuçova Air Base, parked by and painted in the colours of the Albanian flag, reminding a long history of aviation in this country. The placement of aircraft was a joint initiative of Tirana International Airport and Military Air Force of Rinas.

Nëntor 2012

Me 28 Nëntor, Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës festoi 100 vite pavarësi të shtetit shqiptar. Ngjyrat e flamurit kombëtar u vendosën gjithandej në ndërtesën e terminalit, duke u kthyer në një mirëseardhje të ngrohtë për të gjithë pasagjerët e aeroportit. Fasada e terminalit u vesh me një flamur të stërmadh shqiptar, ndërsa të gjithë ata që kalonin përmes terminalit do të mund të dallonin një aeroplan të kuq të qëmotshëm sjellë në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës nga baza ajrore e Kuçovës. Aeroplani Antonov 2 ishte parkuar në anë të terminalit dhe ngjyrosur me ngjyrat e flamurit shqiptar, duke nxjerrë në pah historinë e gjatë të aviacionit në vendin tonë. Vendosja e aeroplanit ishte një iniciativë e përbashkët e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës dhe forcave ajrore ushtarake të aeroportit të Rinasit.

KEY FIGURES

In 2012, Tirana International Airport served 1,665,331 passengers. The Airport also recorded 20,528 air traffic movements (ATMs) and handled 2,260 tons of cargo.

In comparison with the previous year, passenger numbers decreased by 8.4 per cent, ATMs by 10.7 per cent and cargo by 14.9 per cent. This is the first annual decline in key figures and is attributable to the global financial crisis.

Currently, eleven airlines fly in to and out of TIA, connecting directly the Albanian capital city with 29 destinations.

TIA is committed to offering its passengers, airlines and business customers the best service.

Key figures and growth in percentage

Key Figures	2011	2012
Passengers	1,817,073 (+18.2%)	1,665,331 (-8.4%)
ATMs	22,988 (+10.6%)	20,528 (-10.7%)
Cargo Ton	2,656 (+13%)	2,260 (-14.9%)



SHIFRAT KRYESORE

Në vitin 2012 TIA u shërbeu 1,665,331 pasagjerëve. Aeroporti gjithashtu rregjistroi 20,528 lëvizje trafiku ajror (ATMs) dhe përpunimin e 2,260 ton ngarkesave.

Në krahasim me vitin e kaluar, numri i pasagjerëve u reduktua me 8.4%, ATM-të (lëvizjet në trafikun ajror) me 10.7% dhe sasia e ngarkesës së përpunuar me 14.9%. Kjo është rënia e parë vjetore në shifrat kryesore dhe i atribuohet krizës globale financiare.

Aktualisht 11 linja ajrore fluturojnë në dhe nga Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës, dhe lidhin në mënyrë të drejtëpërdrejtë kryeqytetin shqiptar me 29 destinacione.

Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës është i angazhuar t'i ofrojë pasagjerëve të vet, linjave ajrore dhe klientëve të biznesit shërbimin më të mirë.

Shifrat kryesore dhe përqindja e rritjes

Shifrat kryesore	2011	2012
Pasagjerë	1,817,073 (+18.2%)	1,665,331 (-8.4%)
ATM	22,988 (+10.6%)	20,528 (-10.7%)
Ngarkesa (Kargo) në tonë Cargo	2,656 (+13%)	2,260 (-14.9%)





Tirana International Airport SHPK

**Tirana International Airport Nënë Tereza
Administration Building
Rinas, Tirana
Albania
Phone: +355 4 2381 600
Fax: +355 4 2381 545
info@tirana-airport.com
www.tirana-airport.com**

**Asset Management and Environment Department
Departamenti i Menaxhimit të Aseteve dhe Mjedisit**

Status: September 2013

Botimi: Shtator 2013